

VENDIM
Nr. 43, datë 17.2.2000

**PËR KALIMIN NË PRONËSI TË NJË SIPËRFAQEJE TRUALLI, NË FAVOR TË KISHËS
KATOLIKE SHQIPTARE, MBI TË CILIN DO TË NDËRTOHET KOMPLEKSI SPITALOR
“ZONJA E KËSHILLIT TË MIRË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 dhe 4, të ligjit nr 7980, datë 27.7.1995, "Për shitblerjen e trojeve", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të Kishës Katolike Shqiptare, të një sipërfaqeje trualli prej 5 hektarësh, sipas gjenplanit që i bashkëlidhet këtij vendimi, mbi të cilin ngrihet kompleksi spitalor "Zonja e Këshillit të Mirë".
Koeficienti i përlogaritjes së çmimit të shitjes së truallit të jetë 0,001.
1. Ngarkohet bashkia e Tiranës për nënshkrimin e kontratës së shitblerjes.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta